



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 12.01.2015
Nr.0204-26/1

PËR: Sokol Bashota, Kryetar i Komunës së Klinës
Haxhi Ibishi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës

LËNDA: KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË RREGULLORES TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË KLINËS Nr.01-031-5713/2014 të pranuar më datën 08.01.2015

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të rregullores Nr.01-031-5713/2014 të miratuar me datën 26.12.2014 nga Kuvendi i Komunës së Klinës, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit, dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik është si vijon:

- Rregullore për Transparencë në Komunën e Klinës.

Me respekt,

Ljubomir Marić
Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësove të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 12.01.2015

Br.0204-26/1

ZA: Sokol Bashota, gradonačelnik opštine Klina
Haxhi Ibishi, predsedavajući skupštine opštine Klina

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI UREDBE SKUPŠTINE OPŠTINE KLINA
Br.01-031-5713/2014 dostavljene dana 08.01.2015

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, na osnovu nadležnosti i odgovornosti određenim po članu 81.4 zakona za lokalnu samoupravu, kao i uredbe br.02/2011, o poljima administrativne odgovornosti kancelarije premijera i ministarstva, prilog XII, nakon razmatranja uredba Br.01-031-5713/2014 usvojene dana 26.12.2014 od strane skupštine opštine Klina, POTVRĐUJE zakonitost akta i ceni da je isti u skladu sa zakonom za lokalnu samoupravu.

Pravni akat koji proizvodi puni pravni efekat je kao sledeće:

- Uredba za transparentnost u opštini Klina.

S'poštovanjem,

Ljubomir Marić,
Ministar administracije lokalne samouprave

Kopija: Besnik Osmani, generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum 08.01.2015
Date

Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-71-	0203-25	1	

Duke u mbështetur në nenin 11, nenin 12 pika 12.2 nën c) nenit 68 pika 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjit nr.03/L-15 për Qasje në Dokumentet Publike, dispozitave të Udhëzimit Administrativ të MAPL-ës nr.05/2013 për Transparencë në komuna të dt.12.07.2013 si dhe në bazë të nenit 10 pika 3, nenit 40.2 nën paragrafit 1 dhe nenit 65 nën pikën 8 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e XI-të, të rregullt për vitin 2014, të mbajtur më 26.12.2014, mori këtë:

VENDIM

Për

Miratim të Rregullore për Transparencë në Komunën e Klinës

I

Miratohet Rregullorja për Transparencë në Komunën e Klinës.

II

Rregullorja si në pikën 1 të këtij vendimi miratohet me qëllim të forcimit të transparencës të të gjitha organeve të komunës gjatë ushtrimit të përgjegjësive publike komunale, angazhimit dhe rritjes së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje si dhe lehtësimit të procedurave ligjore të qasjes së publikut në dokumentet publike komunale.

III

Arsyeshmeria dhe baza juridike dhe ligjore e miratimit të kësaj Rregulloreje qëndron në dispozitën e nenit 68 paragrafi 68.4 të LVL-së si dhe në bazën e dispozitave përkatëse të Udhëzimit Administrativ të MAPL nr.05/2013 për transparencë në Komuna si dhe duke pasur parasysh domosdoshmërinë e shfuqizimit të Rregullore paraprake komunale nr.01-110-101/2005 të dt. 31 Maji 2005.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin nga Kuvendi i Komunës dhe konfirmimit të ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës i MAPL.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr.01-031-5713/2014
Klinë, më 26.12.2014



KRYESUESI,
Dr. Haxhi Ibishi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data 08.01.2015
Datum

Njësia organizative	Kr. i Lendës	Shtojca	Vlera
- 71 -	0208-25		

RR E G U L L O R E

Për

TRANSPARENCË NË KOMUNËN E KLINËS

Klinë, dhjetor 2014

Në mbështetje të dispozitës së nenit 11, pastaj nenit 12 pika 12.2 nënë (c.), e lidhur me nenin 68 pika 68.4 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, pastaj Ligjit nr. 03/L-15 për Qasje në Dokumentet Publike, më pastaj duke iu referuar edhe frymës së dispozitave të Udhëzimit Administrativ të MAPL-ës nr. 05/2013 për Transparencë në komuna të dt.12.07.2013, si dhe në bazë të nenit 10 parag. 1 pika 3 të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e vet të rregullt, të XI-ën me radhë për vitin 2014, të mbajtur më dt. 26.12.2014, shpall të miratuar këtë:

RR E G U L L O R E

Për

TRANSPARENCË NË KOMUNËN E KLINËS

I.- DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Qëllimi dhe fushëveprimtaria

Neni 1

1. Kuvendi i Komunës miraton këtë Rregullore me qëllim të zbatimit të dispozitave, përkitazi me forcimin e transparencës të të gjitha organeve të Komunës gjatë ushtrimit të përgjegjësive publike komunale, angazhimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, si dhe lehtësimin dhe procedurat ligjore të qasjes së publikut në dokumentet publike komunale

2. Me këtë Rregullore po ashtu rregullohet mënyra dhe mundësitë e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje si në mbledhje të Kuvendit të Komunës, mbledhjet e komiteteve komunale, takimet me publikun, konsultimi i publikut para miratimit të akteve juridike të Komunës, publikimi i akteve të miratuara të Komunës, petitionet, kërkesat për informim dhe qasja në dokumentet e lejueshme publike të Komunës, informacionet në internet dhe konsultimi elektronik si dhe formave të tjera të ofrimit të publikut sa më afër mundësive të bollshme për të ndikuar në mënyrën si qeveria lokale të funksionojë gjatë mandatit të saj duke nënkuptuar kështu përgjithësisht ushtrimin e demokracisë në nivelin lokal.

Përkufizimet

Neni 2

Sipas kësaj Rregulloreje përcaktohen përkufizimet dhe nocionet juridike që përdoren në këtë Rregullore si dhe bëhet sqarimi i tyre si në vijim:

„Pjesëmarrja publike”, do të thotë involvimi i banorëve të Komunës në marrje të vendimeve të pushtetit lokal dhe paraqet domosdoshmërinë për ushtrimin e demokracisë në nivelin lokal.

„Njoftimi i publikut për mbledhjet”, nënkupton afishimin e njoftimeve në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Kuvendit Komunal, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, apo të komiteteve dhe organeve tjera komunale, si dhe publikimi i njoftimit të tillë në ueb faqen zyrtare të Komunës, mediet lokale, sipas nevojë edhe në vendet më të frekuentuara.

„Takimet publike”, janë raste të veçanta që organizohen dhe mbahen me publikun, përkatësisht banorët për t’u takuar me zyrtarët publikë për çështjet e interesit të përgjithshëm duke nënkuptuar parashtrimin e pyetjeve, dhënë propozime apo për të ngritur çështje të cilat janë shqetësim për qytetarët. Këtu bëjnë pjesë edhe seancat dëgjimore publike, kontaktet e rregullta me grupet e interesit, sondazhet publike, vizitat për kontaktin si dhe grupet e fokusit.

„Peticioni”, është e drejtë e publikut apo kërkesë kolektive me shkrim që i adresohet Komunës, gjegjësisht Kuvendit të Komunës, për të kërkuar informata dhe shpjegime lidhur më kompetencat dhe funksionet e Komunës.

„Kuvendi i Komunës dhe mbledhjet, përkatësisht seancat e Kuvendit”, Kuvendi është organ më i lartë i Komunës që përbehet prej anëtarëve të tij të zgjedhur në zgjedhjet lokale, ndërkaq që mbledhjet e tij janë të rregullta apo të organizuara në forma tjera ligjore të anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit.

„Komitetet dhe mbledhjet e komiteteve”, komitetet janë trupa-organe ndihmëse të Kuvendit të zgjedhura nga Kuvendi i Komunës, që i ndihmojnë Kuvendit për përmbushjen e përgjegjësisë të caktuara me LVL-ën dhe Statutin e Komunës.

„Dokumenti publik”, është dokumenti zyrtar (i shkruar në letër ose i ruajtur në formë elektronike si regjistrim zëri vizual dhe audio-vizual) lidhur me zhvillimin e politikave, aktiviteteve si dhe vendimeve që i takojnë sferës së përgjegjësisë së Komunës në kuptim të Ligjit për Qasje në dokumente publike.

„Konsultimi publik i akteve komunale”, bëhet në formë të seancave dëgjimore të publikut lidhur më marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit të aktit.

„Qasja në dokumentet publike”, nënkupton shikimin e dokumenteve publike në pajtim me Ligjin për Qasjen në dokumentet publike, me përjashtim të atyre që shpалosja e tyre ndalohet më ligjin përkatës.

„Informacionet në internet ose Konsultimi elektronik”, sipas kësaj Rregulloreje nënkuptohen të gjitha të dhënat dhe dokumentet e komunës të cilat publikohen në ueb faqen zyrtare komunale të internetit, e cila freskohet dhe azhurnohet nga Zyra e teknologjisë informative në bashkëpunim më Zyrën e informimit dhe komunikimit më publikun, këtu hyn edhe Posta elektronike.

II. FORMAT E PJESËMARRJES PUBLIKE DHE TRANSPARENCA

1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij

Neni 3

1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit si dhe subjekteve që janë të interesuara për çështjen që është objekt diskutimi dhe shqyrtimi.

2. Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës ose Komitetit përkatës, siguron kushtet e pjesëmarrjes së publikut në mbledhjet e parapara.

Njoftimi për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij

Neni 4

1. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ose Komitetit përkatës nëpërmjet Zyrës së informimit dhe komunikimit më publikun e njofton publikun, së paku 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së rregullt ose përjashtimisht 3 (tri) ditë në raste të mbledhjeve të jashtëzakonshme përmes:

- 1.1. tabelës së shpalljeve të Komunës,
- 1.2. shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës,
- 1.3. medieve të shkruara dhe elektronike dhe,
- 1.4. ueb-faqes zyrtare të Komunës.

2. Njoftimet publike sipas paragrafit 1 të këtij neni domosdoshmërisht duhet të përmbajnë:

- 2.1. datën e mbajtjes së mbledhjes,
- 2.2. kohën mbledhjes,
- 2.3. vendin e mbledhjes,
- 2.4. rendin e ditës,
- 2.5. materialet e mbledhjes.

3. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës ose të komiteteve të tij mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

4. Me vendim të arsyetuar, Kuvendi i Komunës ose komiteti përkatës, i shpall mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.

2. Publikimi i akteve të Komunës

Neni 5

1. Statuti, rregulloret, vendimet dhe aktet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk është i kufizuar me legjislacion në fuqi për qasje në dokumente publike, bëhen publike një javë pas mbledhjes në të cilën janë marrë vendimet, ndër të tjera përmes:

- 1.1. tabelës së shpalljeve të Komunës,
- 1.2. shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës,
- 1.3. medieve të shkruara dhe elektronike lokale dhe,
- 1.4. ueb-faqes zyrtare të Komunës.

2. Buxheti i Komunës dhe planet e Komunës janë dokumente publike.

3. Komuna me shpenzimet e saja merr masa përkatëse për t'i vënë këto dokumente në dispozicion të publikut, mjeteve të informimit dhe palëve të interesuara në formë të plotë ose

të shkurtuar, sipas kërkesës së palëve të adresuar përmes Zyres për informim dhe komunikim më publikun.

4. Vendimi për aktet komunale në të cilat nuk lejohet qasja e publikut, mund të merret vetëm kur është në pyetje mbrojtja e interesit publik në pajtim me Ligjin për Qasje në dokumente publike.

3. Kërkesa për informim dhe peticion

Neni 6

1. Çdo subjekt fizik ose juridik i interesuar ka të drejtë të parashtojë kërkesë për informim lidhur më realizimin e ndonjë të drejte, të ngrit iniciativë qytetare dhe paraqet peticion për çështjet që janë përgjegjësi të Komunës.

2. Kërkesat, iniciativat qytetare si dhe peticioni shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit prej 60- ditësh siç është përcaktuar në nenin 70 të LVL-ës.

3. Subjektet e përmendura më lart, mund t'i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës për çështjet që janë kompetencë e tij, në mënyrë të pakufizuar, e që kanë të bëjnë me:

3.1. rregullimin e qytetit,

3.2. mirëmbajtjen e infrastrukturës së Komunës,

3.3. urbanizmin e qytetit dhe të fshatit,

3.4. mirëmbajtjen e mjedisit lokal dhe,

3.5. çështjet të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.

4. Një iniciativë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të peticionit, me propozim të veçantë të çështjes që është në interes të qytetarëve në kuadër të kompetencave të Komunës dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes Kryetarit të Komunës, respektivisht drejtorisë që është kompetente për çështjen e propozuar në peticion.

5. Peticioni duhet të jetë i nënshkruar nga më shumë se 100 qytetarë të regjistruar në listat e votuesve.

6. Çdo peticion duhet të përmbajë: adresën e organizatorit, emrat, mbiemrat, numrat e letërnjoftimit, adresën e nënshkruesve dhe lëndën e peticionit që kërkohet të shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës. Komunitetet mund t'i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës përmes Komitetit të komuniteteve. Përmbajtja e peticionit duhet të jetë siç është caktuar më lart. Një peticion, i cili nuk përmban elementet e duhura, nuk konsiderohet i vlefshëm.

7. Drejtoria kompetente për çështjen që është objekt i peticionit, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga pranimi i peticionit dhe shqyrtimit të tij si të vlefshëm në aspektin formal do t'ia prezantojë Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Përfaqësuesit e parashtruesve të peticionit kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të Komitetit dhe të Kuvendit të Komunës, me rastin e shqyrtimit të peticionit.

8. Pas diskutimit publik në Kuvend, Kryetari i Komunës apo zyrtari i autorizuar prej tij, jo me vonë se 15 ditë nga dita e shqyrtimit, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.

9. Në rast kur peticioni lidhet me çështje për të cilat Komuna nuk është drejtpërdrejt kompetente, Kryetari i Komunës ose Zyrtari për informim, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e 8 të nenit 6 të kësaj Rregulloreje, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit se është jo kompetente dhe e procedon atë tek organi kompetent duke informuar edhe parashtruesin e kërkesës.

4. Takimet me publikun

Neni 7

1. Në pajtim me dispozitën e nenin 68 paragrafi 1 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, çdo vit Komuna detyrimisht mban të paktën dy takime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilin takim mund të merr pjesë çdo qytetar apo organizatë me interes për Komunën.

2. Njëri nga takimet me publikun mbahet gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit, ndërkaq që takimi i dytë mbahet në pjesën e dytë të vitit.

3. Përveç dy takimeve të detyrueshme me publikun, Kuvendi i Komunës do të shqyrtojë mundësinë për të mbajtur mbledhje shtesë sa më pranë qytetarëve (vendbanimeve, fshatrave, lagjeve), për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, shfrytëzimin e pronës komunale, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat komunale, si dhe çështje tjera në interes të përgjithshëm.

4. Njoftimi i publikut bëhet dy javë para datës së mbajtjes së takimit publik, Kuvendi i Komunës nëpërmjet Zyrës përgjegjëse për informim informon publikun përmes:

- 4.1. tabelës së shpalljeve të Komunës,
- 4.2. shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës,
- 4.3. medieve të shkruara dhe elektronike dhe,
- 4.4. ueb- faqen zyrtare të Komunës.

5. Njoftimi publik sipas paragrafit 4 të këtij neni duhet të përmbajë domosdoshmërisht këto të dhëna:

- 5.1. datën e takimit,
- 5.2. kohën e takimit,
- 5.3. vendin e takimit dhe,
- 5.4. rendin e ditës.

5. Pjesëmarrja e zyrtarëve më të lartë komunalë është e obligueshme, si kryetari i Komunës, nënkryetari i Komunës, kryesuesi i Kuvendit, drejtori i Administratës së përgjithshme, drejtorët e drejtorive, udhëheqësi i Zyrës komunale për komunitete dhe kthim, si dhe zyrtarë të tjerë kompetentë për çështjet që janë dhënë në diskutim dhe shqyrtim.

6. Kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku gjatë tubimit evidentohen në procesverbal nga personi i autorizuar dhe shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda 15 ditëve pas përfundimit të takimit publik.

5. Konsultimi i publikut para miratimit të akteve komunale

Neni 8

1. Aktet normative nënligjore të Kuvendit të Komunës ose organeve tjera komunale, përfshirë Statutin, rregulloret dhe vendimet i nënshtrohen diskutimit publik para miratimit.

2. Organi propozues përgatit tekstin e projekt-aktit dhe cakton mënyrën e zhvillimit të konsultimit me grupet e interesit, seancat dëgjimore me publikun dhe format tjera të pjesëmarrjes së publikut.

3. Zyra përgjegjëse për informim njofton publikun dy javë para seancës së konsultimit publik përmes:

- 3.1. tabelës së shpalljeve të Komunës,
- 3.2. shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës,
- 3.3. medieve të shkruara dhe elektronike dhe,
- 3.4. ueb- faqen zyrtare të Komunës.

4. Njoftimi publik sipas nenit 8 paragrafi 3 duhet të përmbajë domosdoshmërisht:

- 4.1. datën e mbledhjes,
- 4.2. kohën e mbledhjes,
- 4.3. vendin e mbledhjes dhe,
- 4.4. rendin e ditës.

5. Organi propozues i aktit merr pjesë aktivisht në konsultim, shpjegon përmbajtjen e aktit para publikut dhe evidenton propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve, ndërkaq propozimet, vërejtjet, rekomandimet apo edhe sugjerimet shqyrtohen brenda kornizës dhe lejueshmërisë ligjore dhe një afati të arsyeshëm nga përfundimi i konsultimit.

6. Organi që ka propozuar aktin duhet të informojë Kuvendin Komunës për propozimet e dhëna në diskutim publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara si dhe ato të marra parasysh. Me rastin e miratimit të aktit, Kuvendi i Komunës kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të akti, normalisht ato që e kanë mbështetjen dhe arsyetimin ligjor.

6. Qasja në dokumentet publike të Komunës

Neni 9

1. Çdo person fizik apo juridik pa diskriminim ka të drejtë në qasje të dokumenteve të organeve komunale, bazuar në Ligjit për Qasjen në Dokumente Publike.

2. Kjo Rregullore vlen për të gjitha dokumentet që mbahen nga organet kompetente të Komunës, të hartuara apo të pranuar nga këto organe, për të gjitha fushat dhe aktivitetet e Komunës në përputhje me ligjin.

3. E drejta nga paragrafi 2 i këtij neni i siguron personat fizik dhe juridik të jenë të informuar për politikën, vendimet dhe për punën e organeve komunale, këto dokumente duhen të jenë të qasshme për publik, krejt kjo në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe udhëzimet tjera.

4. Zyra për informim është e obliguar t'i zbatojë detyrimet ligjore rreth procedurës për qasje në dokumentet publike në pajtim me ligjin ashtu që fillimisht e bën pranimin, shqyrtimin fillestar dhe orientimin e kërkesës në pajtueshmëri me ligjin.

Kërkesa dhe procedura për qasje në dokumente publike

Neni 10

1. Kërkesa për qasje në dokumente publike parashtrohet në formë të shkruar, duke e përshkruar informacionin që kërkohet, në mënyrë që Komuna ta identifikojë dokumentin. Parashtruesi nuk është i detyruar t'i jap arsyet për parashtrimin e kërkesës.

2. Nëse kërkesa nuk është e saktë lidhur me informacionin që kërkohet, organi kërkon nga parashtruesi që të qartësojë kërkesën.

3. Organet kompetente komunale e kanë për obligim që në afat prej shtatë (7) ditësh, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe e informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim.

4. Refuzimi i kërkesës bëhet me vendim me shkrim për refuzim të saj të plotë ose refuzimit të pjesërishtëm, ndërsa qe parashtruesi i kërkesës mundet që brenda 15 ditësh pas marrjes së përgjigjes të parashtrojë kërkesën për rishqyrtimin e çështjes me pretendimin e rishqyrtimit të vendimit.

5. Kërkesa për qasje ne informacion dhe dokumente publike duhet të përmbajë:

5.1. emërtimin e institucionit të Komunës,

5.2. përshkrimin e përmbajtjes së informacionit që kërkohet,

5.3. të dhënat shtesë të cilat lehtësojnë gjetjen e dokumentit zyrtar,

5.4. të konkretizohet se informacioni kërkohet për shikim apo dhënie të kopjes së dokumentit,

5.5. kopja e dokumentit, pas pagesës së shpenzimeve të domosdoshme, t'i dërgohet përmes postës, me fax, në mënyrë elektronike apo në ndonjë mënyrë tjetër dhe,

5.6. emrin, mbiemrin adresa, tel., adresa elektronike.

Neni 11

1. Afati për realizimin e se drejtës mund të vazhdohet deri në 15 ditë në rastet kur kemi të bëjmë me dokumente publike të cilat janë jashtë organeve të Komunës dhe në rastin kur përmes një kërkesë kërkohen qasja në disa dokumente publike.

2. Në rastet kur organet komunale nuk përgjigjen brenda afatit kohor nga paragrafi 3 i nenet 10 të kësaj Rregulloreje parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të fillojë procedurën para Avokatit të Popullit apo institucioneve të tjera publike dhe gjykatës kompetente.

7. Informacionet në internet

Neni 12

1. Qeveria komunale në ueb faqen zyrtare të saj të internetit do të sigurojë informacione të cilat kërkohet që t'i vihen në dispozicion publikut e në pajtim më ligjin.
2. Çdo drejtori inkurajohet që në ueb faqen zyrtare të Komunës të vejë në dispozicion publikut sa më shumë informacione dhe sa më shumë dokumente lidhur më veprimtarinë e tij, ato për të cilat më ligj nuk ndalohe shpalesja dhe publikimi i tyre.
3. Ueb faqja komunale e internetit duhet të rishikohet për nga saktësia dhe të azhurohet se pakut një herë në muaj nga Zyra e informimit dhe Zyra e teknologjisë informative.

Transparenca në Komunë dhe plani i veprimit

Neni 13

1. Komuna harton Planin e veprimit për transparencën në Komunë, në pajtim më ligjin dhe udhëzimet përkatëse.
2. Plani nga paragrafi 1 i këtij neni përfshinë veprimet dhe përmbajtjen si nga neni 9 i Udhëzimit Administrativ nr. 05/2013 për Transparencë në Komuna.

Neni 14

Raportimi i lëndëve

Komuna harton raport vjetor për vitin paraprak, në të cilin përfshihet edhe raportimi i Zyrës së informimit për numrin e rasteve në të cilat janë lejuar qasjet, numri i rasteve në të cilat janë refuzuar qasjet në dokumente, si dhe arsyet e këtyre refuzimeve.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 15

Kryetari i Komunës, të gjithë drejtorët e drejtorive me resorët e tyre si dhe institucionet e tjera publike komunale, pastaj Zyra për informim së bashku më Zyrën e teknologjisë informative janë përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 16

Në rast të kolizionit të dispozitave të kësaj Rregulloreje me LVL-ën apo akteve të tjera të Pushtetit qendror, si dhe në raste të zbrastërës tjetër juridike, në këtë Rregullore, drejtpërsëdrejti vlejné dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 i dt.20 shkurt

2008, apo edhe dispozitat e akteve të tjera të Pushtetit qendror dhe ministrive kompetente që përligjojnë çështjen lëndore deri në harmonizimin ligjor të këtij akti.

Shfuqizimi

Neni 17

Më hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet: Rregullorja komunale për Konsultim dhe Pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje, nr. 01-110-101/2005 e dt. 31. maj 2005.

Hyrja në fuqi

Neni 18

Rregullorja për Transparencë në Komunën e Klinës hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Nr. 01-031-5713/2014
Klinë, më dt. 26.12. 2014

KUVENDI I KOMUNËS



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi